

HARTIMI I PROJEKTIT PER :

**“LINJA E DERGIMIT TE FURNIZIMIT ME UJE TE
AEROPORTIT TE VLORES”**

**Raporti Paraprak i Vleresimit te
Ndikimit ne Mjedis**

PERGATITUR NGA:

“TAULANT” sh.p.k.

QKL, LN-7574-03-2014

Eksperte mjedisi:

Ditika Qatipi

Bashkepunim me, “EBS” sh.p.k.

Msc.Ing.Mjedisi Nelisa HAXHI

TIRANE 2024



PERMBAJTJA E RAPORTIT

1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM ,METODIKA E ZBATUAR DHE KUADRI LIGJOR MJEDISOR QE LIDHET ME PROJEKTIN.....	4
2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR, ZONA E ZBATIMIT DHE GJENDJA AKTUALE E FURNIZIMIT ME UJE.....	9
3. PËRSHKRIM I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHEM PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME FOTOGRAFI.	10
4. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI.....	13
5. NJË IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR.....	14
6. PËRSHKRIM PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE.	16
7. INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA.	17
8. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË.	18
9. MUNDËSITË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME SI DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN.	19
10. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.	20
11. PLANI I MONITORIMIT	29
12. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).....	33
13. CERTIFIKATËN DHE LICENCËN PËRKATËSE TË QKL-SË, TË SPECIALISTIT QË KA HARTUAR RAPORTIN PARAPRAK TË VNM-SË.....	33

Lista e Figurave

Figura 1:Paraqitja ne harte e zonave te mbrojtura ne afersi te zones se projektit.....	11
Figura 2:Grafiku i Punimeve	17

Lista e Tabelave

Tabela 1: Matrica e Çeshtjeve/Ndikimeve mjedisore	15
Tabela 2: Shkarkimet e shkaktuara nga projekti.....	16
Tabela 3:Matrica per masat zbutese.....	20
Tabela 4: Ndikimet dhe masat lehtesuese per, gjeologjine dhe dherat gjate ndertimit.....	24
Tabela 5: Permbledhje e ndikimeve dhe masave lehtesuese mbi ujerat siperfaqesore dhe nentokesore gjate ndertimit	25
Tabela 6: Permbledhje e ndikimeve kryesore dhe masat lehtesuese rreth zhurmes.....	27
Tabela 7: Plani Monitorimit.....	31



PARATHENIE

Hartimi i raportit paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis, është kryer në bazë të **Ligjit Nr.10440 datë 07.07.2011** "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", **neni 8, Shtojca II** (Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis), **pika 10** (Prodhime infrastrukturore); **ligjit Nr.12/2015 Per disa ndryshime në ligjin (e sipercituar) nr.10440 datë 07.07.2011** ; **Ligjit Nr.128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10440, Datë 7.7.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis "**, të ndryshuar ; **VKM nr. 686, datë 29.07.2015** "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis(VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore" (tek e cila është marrë përmbytja e këtij raporti paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis) dhe **Vendimit nr. 95, datë 14.02.2018** "Për disa shtesa dhe ndryshime tek VKM nr. 686, datë 29.07.2015".



1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM ,METODIKA E ZBATUAR DHE KUADRI LIGJOR MJEDISOR QE LIDHET ME PROJEKTIN

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis ka per qellim te identifikojë ndikimet ne mjedis te projektit te propozuar “**Linja e Dergimit te Furnizimit me Uje te Aeroportit te Vlores**” ne territorin e Bashkise Vlore si dhe te rekomandoje masat zbutese qe duhet te merren per parandalimin apo minimizimin e ndikimeve.

Raporti paraqet gjendjen e mjedisit përpara zbatimit të projektit dhe ndikimet e pritshme në mjedis në aspektin e ndikimit në tokë, ujë, ajër, bimësi, habitate natyrore , ne popullsi dhe siguron masa zbutëse dhe monitoruese të efekteve negative në mjedis.

Procesi i hartimit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM), ndihmon ne permiresimin e çdo lloj projekti ne respektimin dhe mbrojtjen maksimale te mjedisit te zones ku ai zbatohet. Ky raport eshte hartuar bazuar ne legjislacionin mjedisor ne fuqi dhe ka per qellim te identifikojë, parashikojë dhe vleresojë te gjitha ndikimet e mundshme ne menyre sistematike, te kuptueshme dhe objektive.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis i pergjigjet ne thelb ketyre pyetjeve kyç:

- A. Si do te ishte mjedisi pa projektin?**Kjo do te identifikojë dhe pershkruajë gjendjen aktuale te burimeve dhe karakteristikat ekzistuese ne mjedisin qe mund te ndikohet nga projekti dhe se si keto do te zhvillohen ne mungese te projektit.
- B. Çfare do t’i ndodhe mjedisit, si pasoje e projektit?**Kjo do te pershkruajë mjedisin siç eshte pa projektin dhe se si ai do te ndryshojë si pasoje e projektit ne aspektin e burimeve mjedisore apo njerezve (receptoret) qe jane te ndikuar, natyren dhe shkallen e ndryshimit, shtrirjen e tij gjeografike dhe kohore.
- C. A perben kjo nje shqetesim?** Parashikimi i ndikimit nuk eshte i mjaftueshem.
- D. Nese eshte i rendesishem a mund te bejme ndonje gje ne lidhje me te?**Se fundi, eshte e rendesishme te kuptohet se, ne qofte se ndikimi eshte i rendesishem, mund te behet diçka per te shmangur, reduktuar, korrigjuar apo kompensuar per te. Zhvilluesi i projektit mund t’i perfshijë keto masa zbutese ne propozimet e projektit dhe autoriteti kompetent mund t’i perfshijë kerkesat perkatese ne kushtet e lejes se dhene.

Objektivi kryesor i VNM-se eshte te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore te projekteve te reja te zhvillimit. Brenda ketij qellimi, procesi i VNM-se kerkon qe:

- te konsiderohen alternativat per vendndodhjen dhe ndikimet mjedisore shoqeruese;
- te permiresohet plani mjedisor i propozimit;
- te sigurohet qe burimet jane perdorur si duhet dhe ne menyre eficientë;
- te identifikohen masat e duhura per zbutjen e ndikimeve te mundshme te projektit;
- te vendosen kushtet per ndertimin;

- te ndihmohet vendim marrja dhe informimi i publikut.

Procedura e VNM-se perfshin:

- a) procesin paraprak te VNM-se;
- b) procesin e thelluar te VNM-se.

Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM) shyrton kerkesat per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe ne fund te seciles procedure, paraprake apo te thelluar te VNM-se, merr Vendimin per VNM-ne paraprake, ndersa per VNM-ne e thelluar pergatit Deklaraten Mjedisore me rekomandimet perkatese dhe ia dergon Ministrise.

Ne perfundim vendim marrja konsiston ne:

- Vendim - leshuar nga AKM-ja ne perfundim te procedures paraprake te VNM-se
- Deklarate Mjedisore - leshuar nga Ministri ne perfundim te procedures se thelluar te VNM-se.

Sic eshte thene ne fillim te raportit, projekti i propozuar “Permiresime te sistemit te furnizimit me uje te SH.A UK Vlore” i nenshtrohet procedures paraprake te vleresimit te ndikimit ne mjedis.

Theksojme se gjate procedures paraprake te VNM-se, referuar VKM nr. 247, date 30.04.2014 “Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore”, Kreu I, nuk eshte detyrim ligjor te behet Konsultim Paraprak me banoret e zones. Perpara marrjes se Vendimit AKM-ja publikon aplikimin per VNM paraprake ne web te saj, ku komuniteti i interesuar mund te shpreh mendimin e tij.

➤ **Baza ligjore lidhur me projektin**

- Ligji Nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”
- Ligji Nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”
- Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 53/2020 datë 30.4.2020 "Për disa ndryshime në ligjin Nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar.
- Ligji Nr.10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, te ndryshuar.
- Ligji Nr.52/2020 datë 30.4.2020 "Për disa ndryshime në ligjin Nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.
- Ligjit Nr.10440 datë 07.07.2011 ”Për vleresimin e ndikimit në mjedis”, te ndryshuar.
- Ligji Nr.12/2015 “Per disa ndryshime ne ligjin Nr.10440 datë 07.07.2011 ”Për vleresimin e ndikimit në mjedis”, te ndryshuar”.



- Ligj Nr.128/2020, datë 22.10.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar"
- Ligji Nr.9587, date 20.7.2006 "Per mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar.
- Ligji Nr.68/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar.
- Ligji Nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis"
- Ligji Nr.10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar.
- Ligji Nr.156 date 10.10.2013 për disa ndryshime në ligjin Nr.10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.
- Ligji Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

- VKM nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis(VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore"; dhe Vendimi nr. 95, datë 14.02.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime tek VKM nr. 686, datë 29.07.2015".

- VKM Nr.912 date 11.11.2015 "Per miratimin e metodologjise kombetare te procesit te VNM-se "".

- Vendim i KM Nr.419, datë 25.6.2014 Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja.

- Vendim Nr.247, Date 30.4.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".

- VKM nr.16, datë 04.01.2012 për "Të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor".

- VKM nr. 575 date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte".

- Vendimi Nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".



Sipas ligjit Per Mbrojtjen e Mjedisit, vleresimi i ndikimit ne mjedis i nje projekti te propozuar zhvillimi eshte vleresimi i ndikimeve te rendesishme, te mundshme te asaj veprimtarie ne mjedis.

Gjate procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis, kryhen identifikimi, pershkrimi dhe vleresimi ne menyren e duhur i ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie, duke percaktuar efektet e mundshme te drejtperdrejta dhe jo te drejtperdrejta mbi token, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimen, shendetin e njeriut, floren dhe faunen, peizazhin natyror, pasurite materiale, trashegimine kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre te ndersjellta.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis zbaton parimin e parandalimit qe ne fazen e hershme te planifikimit te projektit, me qellim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis, permes harmonizimit dhe pershtatjes se saj me kapacitetin bartes te mjedisit.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjese e pergatitjeve per planifikimin e nje projekti zhvillimi dhe para kerkimit te lejeve perkatese te zhvillimit.

Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, dhe aktet nenligjore qe rrjedhin prej tij, te perafuara plotesisht me Direktiven e Bashkimit Evropian per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis ka per qellim te siguroje nje nivel te larte te mbrojtjes se mjedisit, permes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit te demeve ne mjedis, nga projekte te propozuara para miratimit te tyre per zhvillim dhe garantimin e nje procesi te hapur vendimmarrjeje, gjate identifikimit, pershkrimtit dhe vleresimit te ndikimeve negative ne mjedis, ne menyren dhe kohen e duhur si dhe perfshirjen e te gjitha paleve te interesuara ne te.

Ky ligj zbatohet per projektet e propozuara, private apo publike, te cilat mund te shkaktojne ndikime te rendesishme negative, te drejtperdrejta ose jo, ne mjedis, si pasoje e madhesise, natyres apo vendndodhjes se tyre.

Në zbatim të kërkesave të legjisllacionit mjedisor shqiptar, çdo projekt i cili synon të zhvillohet në mjedis, që në fazat e para të tij duhet t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të aktivitetit që propozon, në mënyrë që të garantohet një proces i drejtë të vendimmarrje në lidhje me të.

Kryerja e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të një aktiviteti të propozuar, proces i cili finalizohet me hartimin e Raportit përkatës, synon konsiderimin e çështjeve që lidhen me mjedisin pritës, fizik e social, që në fazat fillestare të tij. Në thelb të vlerësimit mjedisor të projektit qëndron evidentimi i pikëprerjeve të tij me legjisllacionin në fuqi, vlerat natyrore që gjenden në zonën e projektit dhe si e sa do të ndikohen në rast të zbatimit të tij. Nëpërmjet identifikimit të ndikimeve të mundshme negative të zbatimit të projektit në vlerat natyrore të zonës pritëse, që në fazën e projektimit mund të merren masat e nevojshme për përmirësimet e duhura teknologjike, me qëllim zbutjen e ndikimeve dhe përshtatjen me kapacitetin bartës të mjedisit.

Qëllimi i kryerjes së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projektit të propozuar është:

- Të japë informacion për vendimmarrësit për pasojat mjedisore të tij.
- Të promovojë zhvillimin miqësor dhe të qëndrueshëm me mjedisin duke propozuar masat e nevojshme për shmangien dhe minimizimin e ndikimeve të mundshme negative të identifikuar gjatë këtij procesi.

Kryerja e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të veprimtarisë së propozuar do të realizohet nëpërmjet përmbushjes së objektivave specifike si:

- Evidentimit të pikëprerjeve dhe bashkërendimit të projektit me kuadrin rregullator legjislativ kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit.
- Identifikimit të statusit të zonave ku do të zhvillohet projekti.
- Përshkrimit të vlerave natyrore dhe mjedisore në zonën e projektit.
- Identifikimit të ndikimeve të mundshme thelbësore negative në vlerat natyrore dhe në mjedis duke propozuar njëkohësisht masat për zbutjen e tyre dhe mbrojtjen e mjedisit nga këto ndikime.

Raporti i VNM përmbledh një përshkrim të projektit të propozuar, përshkrimin e karakteristikave të mjedisit ekzistues pritës, analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis të projektit të propozuar, planin e masave për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve të mundshme negative (PMM) dhe programin e monitorimit mjedisor.



2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR, ZONA E ZBATIMIT DHE GJENDJA AKTUALE E FURNIZIMIT ME UJE

Projekti “Linja e Dergimit te Furnizimit me Uje te Aeroportit te Vlores” perfshin nje list objektesh te shperndara ne nje hapësire te konsiderueshme duke perfshire nje siperfaqe te Njesise Administrative Novosele ne Bashkine Vlore.

➤ Qellimi i projektit te propozuar

Projekti synon sigurimin e furnizimit me ujë të sigurt, higjenikisht të pastër me mbulimin e kostos dhe tarifat e pranueshme socialisht për zonat e përzgjedhura në zonën e studimit. Ky furnizim përfshin: stacionet e pompimit, linjën e dergimit.

➤ Gjendja ekzistuese

Për realizimin e projektit, projektuesit i kërkohet të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me projektin që duhet të hartojë për furnizimin me ujë sipas kësaj detyre të projektimit.

- Prurja e projektuar për furnizimin me ujë të Aeroportit të Vlorës është 30 l/s (dhënë në detyrën e projektimit).
- Studimi h/gjeologjik i burimit (pus shpimi) janë ekzistues
- Materiali i tubacionit të jetë HDPE me presion 10 atm

➤ Detyrat Kryesore që do të Zgjidhe Projekti

Nëpërmjet ketij projekti synohet:

A. Rikonstruksion i Linjës se Dërgimit të Furnizimit me Ujë të Aeroportit të Vlorës, Njësia Administrative Vlorë

➤ Për këtë projekt është e nevojshme të jepen:

- Sasia e kërkuar e ujit për nevoja të operimit të Aeroportit e përcaktuar nga projektet e tij të brendshme (jashtë llogaritjeve të ketij projekti)
- Destinacioni fundor i tubacionit që lidhet me planimetrinë dhe funksionalitetin e Aeroportit
- Pus – shpimi i destinuar për furnizimin me uje të Aeroportit



3. PËRSHKRIM I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME FOTOGRAFI.

Zona ku do të zbatohet projekti i propozuar i përket rrethit Vlore, njesise administrative Novosele.

Kjo njesi administrative eshte pjese e Bashkise Vlore, rrethit Vlore, qarkut Vlore.

Vlora është një qytet bregdetar në jugperëndim të Shqipërisë. Vlora është qyteti i dytë më i madh portual pas Durrësit, me një popullsi afërsisht 200.000 banorë.

Fushat, livadhet dhe pyjet e Vlores ofrojnë mjedise te favorshme per rritjen e bimeve dhe kafsheve te ndryshme. Zona e Vlores kultivon bime te ndryshme bujqesore si perime, drithera, kultura foragjere etj. Vlora kultivon druret frutore te zones se Mesdheut si: agrumet (portokallet, limonat, mandarinat) dhe ullinjte. Vreshtaria ze vend paresor.

Bimet barishtore dhe eterovajore qe sherbejne ne mjekesine popullore dhe farmaceutike shtrihen nga zona fushore e deri ne ate malore.

Ne zonen e shkurreve rritet valanidhi dhe perralli, te njohur per vlerat kurative.

Ne lartesine 800 m mbi nivelin e detit, shtrihet zona e dushkut (nga qafa e Mazharit deri ne Bristan.Mbi 800 m mbi nivelin e detit gjendet zona e pishave dhe bredhit (dendur ne Llogora) si dhe bushi e shtogu.Kullotat subalpine gjenden ne lartesine 700-1800m ne Vastak, ne majen e Cikes dhe malet e Rimit.

Fauna dhe eritrofauna eshte e pasur ne lloje ne gjithe zonen: sorkadhja, derri i eger, ujku, cakalli dhelpra, lepuri i eger (sidomos ne pyllin e Llogorait), eritrofauna e pasur si ne toke ashtu edhe ne ujera: qukapiku, harabeli, mellenja, laraska, zhgaba, skifteri, petruti, thellezat, pellumbat e eger, shapkat (liqeni i Orikumit). Jo rralle shfaqen dhe delfinet e Mesdheut. Zona e Vlores pret te pakten 33 lloje qe meritojne mbrojtje prej te cileve 14 te vleresuar si te rrezikuar per t'u zhdukur, si foka murgeshe mesdhetare (Monachus Monachus), breshka (Caretta Caretta), tritoni i kreshperuar (Triturus Cristatus) pelikani me krrela(Pelecanus Crispus), shqipja me bllama (Aquila clanga).

Laguna e Nartes eshte zone me rendesi nderkombetare me nje numer zogjsh ujore me teper se 48.700 individe. Ne dimer me shume se 23% e gjithe zogjve ujore te Shqiperise strehohen ketu. Kurse laguna e Orikumit dallohet kryesisht per rosat.

Punimet e ndertimit do te realizohen kryesisht brenda zones se banuar dhe nuk do te kemi prishje te siperfaqeve te medha bimore.

Ne siperfaqet qe do te kete nevojë per rehabilitim , mbjellja e pemëve dhe bimëve dekoruese do të bëhet në respekt të llojeve tradicionale lokale si qiparis, ulli, bli, pishë, palmë, karafil, bungëvile, mimosa etj.

- ***Pershkrimi i zonave te mbrojtura prane vendit ku propozohet projekti***

Zonat e mbrojtura me te aferta me zonen e projektit te propozuar , ne baze te hartes kombetare te zonave te mbrojtura jane :

Peisazh i Mbrojtur Vjose-Narte

Parku Kombetar Karaburun Sazan
Rezervat Natyror i Menaxhuar Karaburun
Parku Kombetar Llogara
Projekti i propozuar nuk prek asnje nga keto zona te mbrojtura.




Figura 1: Paraqitja ne harte e zonave te mbrojtura ne afersi te zones se projektit

Vizita ne zonen e projektit te linjes se dergimit te furnizimit me uje te Aeroportit te Vlores eshte perqendruar ne objektet e stacioneve te pompimit dhe elemente te caktuar te linjes ku ato jane te dukshme.

Foto nga gjendja ekzisuese :



- Sic shihet nga keto foto per nje zone te projektit , mbulesa bimore perfaqesohet vetem nga shkurre, barishte per te cilat mund te lind nevoja e heqjes dhe pastrimit gjate kryerjes se punimeve te ndertimit. Pas perfundimit te punimeve parashikohet rigjelberim dhe rehabilitim i zones nga pikepamja mjedisore .

4. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI.

Rajoni i Vlorës dallohet për pasurinë e shumëllojshmërinë ujore. Larmia e madhe hidrografike shprehet në objektet ujore, Detet Adriatik e Jon, Lagunat e Nartës, Orikumit dhe Butrintit, ujërat nëntokësore, kanalet kulluese e ujitës. Këto kanë tipare të veçanta hidrologjike, hidrokimike e termike dhe jo në pak raste kanë probleme me ndotjen. Burimet ujore përdoren për qëllime industriale, bujqësore dhe prodhimin e energjisë elektrike si: hidrocentrali i Smokthinës, Bisticës dhe hidrocentralet e vegjël në bregun e detit që tashmë nuk janë në funksionim. Uji është burim shumë i nevojshëm për jetën në rajonin e Vlorës, përdorimi i tij me efektivitet kërkon kuptimin mbi qarkullimin në natyrë, njohjen me kapacitet dhe kufizimet, shpërdorimet, ndotjet dhe menaxhimin e tij.

Në kete rajon “degradimi” i mjedisit ndikon negativisht në shëndetin e popullatës dhe zvogëlon mundësinë për zhvillim të qëndrueshëm të tij. Ndotja është me e madhe pranë zonave fushore. Në këto zona ka dendësi më të madhe të popullsisë.

Rajoni ka një rrjet hidrologjik të pasur. Ai përbëhet nga pellgu ujëmbledhës i detit Adriatik dhe Jon. Regjimi i lumenjve është mesdhetar. Rrjedhja e lëngët e lumenjve është me prurje maksimale në periudhën e ftohtë dhe të lagët. Ndërsa ushqimi bëhet prej ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Në kete rajon, përqendrimi i rrjedhjes gjatë periudhës së ftohtë të vitit, ka kushtëzuar vërshimet dhe përmytjet e shpeshta në zonat fushore të tij. Këto vërshime lidhen me faktorët e klimës dhe të gjeomorfologjisë.

Burimet ujore në gjirin e Vlorës kanë një veçori specifike mbasi formohen pranë bregdetit ose dalin nga burimet nëndetare. Megjithëse rezervat totale të shfrytëzueshme janë të mëdha, shkalla e shfrytëzimit të tyre është ende jo e lartë.

Ekziston një nivel i dytë i drenimit të ujërave nëntokësore (burimet nëndetare). Ato shfaqen nga Uji i Ftohtë deri në skajin verior të Jonufrit. Ekzistenca e burimeve karstike është e lidhur me masën e madhe të shkëmbinjve karbonatikë dhe ujëmbajtjes së fuqishme të tyre që realizohet nga të çarat e shkëmbinjve.

Vetëm një pjesë e vogël e burimeve që dalin në sipërfaqe janë aktualisht në shfrytëzim (rreth 900 l/s). Thithja dhe filtrimi i ujërave të burimeve nëndetare me anën e pompave të fuqishme do të siguronte një furnizim të pandërprerë në zonën turistike madje dhe të qytetit. Burimet



karstike dalin dhe në lartësi 400 m mbi nivelin e detit. Kjo mund të furnizojë mjaft mirë me sasira të mëdha të ujit shumicën e qendrave të banuara që janë në këtë lartësi.

Përsa i përket detit Adriatik (në zonën e gjirit të Vlorës), rol të veçantë në veçorinë e ujërave, i takon rrymave gravitacionale të efektit baticor, derdhjes së ujit të lumenjve dhe gradientit (për shkak të densitetit të ndryshëm). Krahas tyre, rol të rëndësishëm luajnë dhe rrymat e formuara pas procesit të vrondullimit (sidomos në zonat e bregdetit të ulët ranor). Rryma më e madhe formohet gjatë procesit të ujë-këmbimit midis Adriatikut dhe detit Jon duke u përfaqësuar nga një rrymë e ngrohtë me drejtim Jug-Veri. Tejdkushmëria dhe ngjyra e ujit të Adriatikut dhe Jonit në përgjithësi është e lartë. Kjo lidhet me bilancin ujqor negativ dhe zhvillimin e pakët të zooplanktonit. E madhe është tejdkushmëria në Rivierën tonë.

Deti Adriatik dhe Jon ushtron një ndikim në të gjithë komponentët e pejsazhit gjeografik, me të është e lidhur dhe veprimtaria ekonomike e njerëzve në rajon. Në detin Adriatik, temperatura mesatare vjetore është 19 °C, pra ai përbën një det të ngrohtë që favorizon si turizmin balnear ashtu dhe zhvillimin e gjallesave bimore dhe shtazore. Lëkundjet mesatare vjetore të temperaturës së ujërave të Adriatikut janë nga 13 °C në Shkurt në 25°C në Gusht.

Një vend të veçantë në rajon zënë dhe liqenet e kripura bregdetare. Në këtë futen Laguna e Nartës dhe e Butrintit. Formimi i tyre lidhet me evolucionin e bregdetit të ulët. Laguna e Butrintit është më e thellë për shkak të fundosjes tektonike. Lagunat lidhen me detin me kanalet natyrore, në të cilën uji ndryshon drejtimin çdo 6 orë dhe lidhen me baticë-zbaticën. Proceset meteorologjike (era, reshjet) veprojnë në këtë ujë-këmbim vetëm në madhësi dhe jo në drejtimin e tij.

5. NJË IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR

Ndikimet mjedisore për ndërtimin e çdo projekti të furnizimit me ujë janë të lidhura me fazat përkatëse afat- shkurtra dhe afat- gjata të investimit si:

- zbatimi i punimeve / faza e ndërtimit;
- faza e funksionimit dhe mirembajtjes së vepres;

Faza e ndërtimit

Keto ndikime mund të përfshijnë: zhurmat; ndikimet vizuale, kufizimet në akses; pluhuri i cili ndikon në cilësinë e ajrit, germimi i dherave dhe asgjësimi i pjesëve të tepërta si dhëra/ tokë dhe materiale të tjera, rreziqet në zonat ekologjiksht të ndjeshme, flora dhe fauna, etj.

Gjithashtu, ndikime të veçanta që do të konsiderohen gjatë fazës së ndërtimit janë ato të lidhura me ndërprerje apo ndryshime në regjimet e shërbimeve ekzistuese të furnizimit me ujë dhe efektet e mundshme në cilësinë e ujit.

Kohëzgjatja e projektit pritet të jetë 18 muaj, dhe punimet mund të mos zhvillohen në të njëjtën kohë në të gjitha zonat brenda zonave të administruara nga UK Vlore, përfituesit mund të ndiejnë vetëm disa nga efektet dhe për një kohë të shkurtër.

Faza e funksionimit

Ndikimet gjate fazës së funksionimit të veprave të furnizimit me ujë përfshijnë menaxhimin e qëndrueshem të burimeve për të shmangur shfrytëzimin dhe ndikimet negative në mjedisin përreth.

Pjesa që ka të bëjë me rrjetin shpërndarës, si ndikimet në mjedis e shendet nga rrjedhjet apo defektet e mundshme janë minimale gjate fazes se operimit pasi ofrohet nje rrjet tubacionesh teresisht i ri.

Studimi i të dhenave bazë mjedisore është përdorur si bazë për përgatitjen e listës së kontrollit që është përshtatur për të analizuar mjedisin për qëllimin e realizimit të projektit.

Ndikimet e mundshme janë klasifikuar në tri faza, si më poshtë:

- Para ndërtimi / përgatitja e projektit teknik, planimetria dhe vendndodhja.
- Ndërtimi
- Funksionimi dhe mirëmbajtja

Krahasimi i situatave "me projekt" dhe "pa projekt", është bërë në formën e nje matricë për çështjet e ndikimit në mjedis.

Kjo analize prezanton menjëherë çështjet kryesore mjedisore dhe ndikimet e mundshme mjedisore që mund të jenë pozitive apo negative. Ndikimet janë të klasifikuara:

- Ndikim shumë negativ mjedisor (=),
- Ndikim mjedisor negativ për momentin (—),
- Ndikim mjedisor i papërfillshëm (O)
- Ndikimi pozitiv mjedisor (+).

Tabela 1: Matrica e Çështjeve/Ndikimeve mjedisore

Faza	Parametrat mjedisorë	"pa projekt"	"me projekt"
Faza prapake (para ndërtimit)	• Kredibiliteti i furnizimit me ujë	=	+
	• Kredibiliteti i cilësisë së ujit	O	O
	• Ndotja e mundshme	=	+
	• Tokë e zënë dhe zhvendosje e njerëzve	O	O
	• Shfrytëzimi i tokës dhe ndalimi i aktivitetit ekonomik	O	O

Faza e ndertimit	• Ndalimi i përdorimit të tokës	O	O
	• Humbje të bimësisë natyrore	O	—
	• Dëme në rrjedhjen e ujërave ose dëme në habitatin ujor	O	O
	• Ndotja e Ujit dhe e Tokës	O	—
	• Probleme me zhurmat, ndotja e ajrit, trafiku	O	—
	• Erozioni	O	—
	• Punësimi	O	+
Funksionim & Mirembajtje	• Shendet publik	=	+
	• Ndotja e ujit	—	—
	• Erozioni	O	O
	• Rritje të sasisë së tokës	O	O
	• Zgjerim i aktivitetit ekonomik	O	+

Ndikimet pozitive

Në përgjithësi, projekti pritet të ketë një ndikim pozitiv për popullsinë. Cilesia e ujit dhe mundësia e paket e ndotjes së tij do të përmirësohen në mënyrë të ndjeshme dhe kjo do të rezultojë gjithashtu në një shëndet të mirë publik.

Gjithashtu do të përmirësohet për një periudhë afatshkurtër punësimi përgjatë fazës së ndertimit por avantazhet ekonomike do të jenë afat-gjatë.

6. PËRSHKRIM PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE.

Shkarkimet e mundshme në mjedis paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2: Shkarkimet e shkaktuara nga projekti

Lloji i ndotësit	Burimi i prodhimit	Ndikimi në ambientin natyror dhe antropogjenez
Pluhuri	Punimet e gërmimit, transporti i materialeve, përgatitja e betonit, lëvizjet e mjeteve.	Trupëzat mikroskopikë ndikojnë në frymëmarrje, shkaktojnë sëmundje të rrugëve të frymëmarrjes dhe në mushkri. Gjithashtu shkaktojnë ndikim negativ edhe në shikim. Ndikimet e pluhurave në përgjithësi varen si nga madhësia e tyre (sa më të vogla të jenë aq më të rrezikshme janë), por edhe nga përbërja e tyre kimike. Pluhuri me madhësinë e trupzave më të vogël se $5 \times 10^{-6} \mu$ shkakton dëmtim të aparatit frymëmarrjes.

Lëngje/tretës mjetesh	Proçeset e mirëmbajtjes së mjeteve	Shkarkime ne toke
Nënprodukte naftë	Proçedurat e furnizimit të mjeteve me karburant.	Rrjedhje ne toke.
Mbeturina të ngurta	Rregullim fillestar i sipërfaqes së truallit, punimet e ndërtimit, etj.	Një grumbullim i pa kontrolluar i këtyre mbeturinave ka mundësi të shkaktojë ndotje të konsiderueshme të ujit me llumra.
Zhurma	Punimet e gërmimit, lëvizja e mjeteve, punimet e ndërtimit.	Ndikon keq në sistemin e dëgjimit tek njeriu si dhe shëndetin psikologjik dhe trupor të tij.

7. INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA.

Kohëzgjatja e ndikimeve negative në mjedis do të jetë me teper gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit, por edhe për një periudhë kohe që i duhet natyrës për tu rigjeneruar natyralisht, pavarësisht punimeve rehabilituese që mund të ndërmerren.

Kohëzgjatja e punimeve të ndërtimit është përcaktuar në grafikun e punimeve për ndërtimin e ujesjellesit si me poshte (6 muaj) , dhe punimet mund të mos zhvillohen në të njëjtën kohë në të gjitha zonat që përfshin projekti i propozuar, përfituesit mund të ndiejnë vetëm disa nga efektet dhe për një kohë të shkurtër.




Figura 2:Grafiku i Punimeve

Kohezgjatja e funksionimit te projektit : eshte parashikuar 25 vjet.



8. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË.

Zona ku do të zbatohet projekti përfshin një hapësirë të konsiderueshme duke përfshirë disa nga fshatrat e njësise administrative Novosele, Bashkia Vlorë.

- Ndikimet do të kenë një shtrirje të kufizuar në hapësirë, kryesisht lokale, të përqendruar në sipërfaqen ku do të zbatohen punimet e ndërtimit.
- Nuk do të ketë rreze të gjera të shtrirjes së ndikimit dhe impaktive negative, pasi nuk kemi të bëjmë me procese me shkallë të lartë rrezikshmërie në mjedis dhe proceset teknologjike të përzgjedhura për ndërtimin e projektit janë të zakonshme.
- Për minimizimin e shtrirjes në hapësirë të impakteve negative, do të luajne një rol mjaft të rëndësishëm respektimi rigoroz i masave zbutëse të rekomanduara në raportin e VNM-së për secilin nga punimet.

9. MUNDËSITË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME SI DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN.

Gjate kryerjes se operacioneve te ndertimit do te kete krijim te mbetjeve inerte (dhera, masa te vogla shkembore) si rezultat i punimeve te ndryshme. Keto klasifikohen si mbetje ndertimore nese lind nevoja e depozitimit apo zhvendosje nga zona ne nje siperfaqe tjeter. Shoqeria qe do te zbatoje projektin duhet te planifikojte qarte menyren e administrimit te inerteve per te menjanuar mundesine e depozitimit te tyre ne vende te papershtatshme. Nje pjese do te perdoret per mbushjen dhe rehabilitimit e zonave ku jane kryer germime , pjesa qe mbetet do te depozitohet ne vende te caktuara per te cilen investitori do te bjere dakort me organet e pushtetit vendor. Kompania do te marre te gjitha masat per depozitim e tyre ne vende te posacme, te cilat ne perfundim do te rehabilitohet nga pikepamja mjedisore se bashku me siperfaqet e tjera qe do te mbushen .

Gjate aktivitetit duhet te mbahen parasysh kerkesat e Ligjit nr.156 datë 10.10 2013, Per disa ndryshime ne ligjin nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe VKM nr. 575 date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”.

Me shume nevoje per rehabilitim do te kete rikthimi i rrugeve ne gjendjen e meparshme pasi aty do te behet pjesa me e madhe e germimeve si pasoje e ndertimit te rrjetit te ri te shperndarjes , ndertimit te pushtave , ndertimit te lidhjeve me pallatet dhe shtepite etj.

Pjesa me e madhe e germimeve rreth 70 % e tyre do te perdoret per mbushje ndersa nje perqindje e vogel do te shperndahen ne siperfaqe depozitimi te caktuara.

Pjesa e dherave qe do te shperndahen ne siperfaqe depozitimi do te ngjeshet dhe do te mbillet me shkurre dhe bimesi vendase ne menyre qe fenomeni erodues nga shirat dhe ujerat te parandalohet, po ashtu bimesia qe duhet te mbillet duhet te jete autoktone per te mos thyer pejsazhin karakteristik te zones. Keto punime do kryhen ne mbyllje te cdo procesi operacional sipas planit te punimeve respektive.

- Rigjelberim i zonave ku kemi demtim te bimesise.

Duhet te parashikohet zëvendësimi i bimesise të dëmtuar dhe ri- gjelbërim i zonave të punimeve, aty ku ka pas me shume nderhyrje dhe eshte e nevojshme.

Ky proces do te behet mbas nje periudhe e cila rezulton me krijimin e kushteve te pershtatshme per mbjelljen e fidaneve. Kjo behet mbasi te kete perfunduar levizja e dherave nga germimet, mbyllja e fazes ndertimore per projektin dhe risistemimi i dherave perfundimtare duke krijuar mundesine e stabilizimit te dherave dhe mbjelljen e fidaneve perpara periudhes se shirave te pare. Mbjellja e fidaneve rekomandohet ne fund te vjeshtes ose ne dimer ne kohen e pyllzimeve. Rekomandohet te mbillen fidane autoktone te zones.

10. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Në matricen e meposhtme paraqiten masat zbutese reciproke per secilin nga komponentet mjedisore te cilet mund te kene impakte gjate fazave te projektit , te cilat synojne qe ndikimet ne mjedis te jene minimale dhe te shmanget apo parandalohet shkaktimi i impakteve te pakthyeshme ne mjedis.

Komponentet mjedisore te cilet jane marre ne shqyrtim jane: dherat, toka, burimet ujore, cilesia e ajrit, mjedisi akustik, habitatet natyrore, fauna dhe flora, estetika dhe terreni, shendetit i njerzve dhe objektet historike dhe kulturore dhe gjithashtu mjediset jane marre ne shqyrtim sipas tipologjise se tyre duke perfshire mjedisin fizik, mjedisi biologjik, mjedisi social.

Masat zbutese jane hartuar sipas rastit specifik, dhe perfshijne komponentin mjedisor dhe efektet e mundshme te pritshme ne mjediset perkatese.

Zbatimi i masave zbutese me perpikmeri do te garantoje minimizim te impakteve negative ne mjedis dhe parandalimin dhe shmangien e efekteve te pakthyeshme.

Tabela 3:Matrica per masat zbutese

Komponentët mjedisorë	Efektet e mundshme	Masat zbutëse
Mjedisi fizik		
Dherat	<ul style="list-style-type: none"> Dëmtime të strukturës së dheut si pasojë e hedhjes së materialeve, trafikut të transportit, etj. Humbja e dheut sipërfaqesor gjatë gërmimeve. Efektet e gërmimeve nga hedhja e dheut dhe materialeve të tjera. Erozioni si pasojë e rrjedhjeve sipërfaqesore të pakontrolluara dhe shkarkimit të mbeturinave ujore. 	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja e zonave jo-ndërtimore, shmangia e punimeve në zonat e ndjeshme gjatë kushteve me negativitet të lartë, sigurimi i rrugëve për transport, sipas nevojës, riparimi i zonave të dëmtuara. Heqja e dheut sipërfaqesor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja mbas mbarimit të ndërtimeve. Projektimi i drenazheve dhe mjeteve të tjera të hedhjes së mbeturinave për të siguruar stabilitetin e dheut sipërfaqesor.
Toka	<ul style="list-style-type: none"> Dëmtime të tokës gjatë ndërtimit Rrëshqitje mbi skarpata etj. Efektet e gërmimeve / hedhja e dheut dhe materialeve të tjera 	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja e zonave jo-ndërtimore Kryerja e punimeve në mënyrë të tillë që të minimizohet sipërfaqja e ndikuar e tokës.

		<ul style="list-style-type: none"> • Projektimi i sipërfaqeve të pjerreta dhe strukturave mbajtëse për të minimizuar rrezikun, sigurimi i drenazheve, stabilizimit të dheut/mbulimit të bimësisë. • Heqja e dheut sipërfaqësor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja/ripërdorimi mbas mbarimit të ndërtimeve. • Transportimi/hedhja e materialeve nga/në vende të aprovuara.
Burimet ujore	<ul style="list-style-type: none"> • Mbi-shfrytëzimi, shkaktimi i ndryshimeve në burime, modelet e rrjedhjes, etj. me efekte të mundshme mbi përdoruesit e ujit më poshtë (kur flasim për ujra nëntoksore). • Ndërprerja e drenazhimit sipërfaqësor dhe nëntoksor gjatë dhe mbas fazës ndërtimore, krijimi i ujit të ndenjtur, ndotja/infektimi i burimeve dhe/ose furnizimit nga punimet ndërtimore, mbeturinat njerëzore apo të kafshëve, përfshi karburantet & vajrat, mbetjet e rrezikshme, mbeturinat ujore, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Përcaktimi i një përdorimi të qëndrueshëm (të testohet sipas nevojave). • Planifikimi dhe menaxhimi i burimeve në lidhje me autoritetet dhe qytetaret. • Projektimi i kujdesshëm – ruajtja e drenazhimeve natyrore kur është e mundur, sugurimi i drenazhimeve të përshtatshme për mbeturinat ujore, derdhje sipas kërkesave higjienike/të sigurisë e mbetjeve të rrezikshme. • Projektimi i kujdesshëm, mbrojtje e përshtatshme nga bagëtitë; bujqësia, kontakte të rastësishme me njerëzit, materiale të rrezikshme – karburante (përfshi ruajtjen), etj.
Cilësia e ajrit	<ul style="list-style-type: none"> • Pluhuri dhe tymrat gjatë ndërtimit. • Efektet nga trajtimi i ujit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të kontrollohet pluhuri me ujë, të kontrollohen metodat e ndërtimit dhe impjanti, afatet e punimeve, shpejtësia e automjeteve. • Të minimizohen punimet e mëdha brenda komuniteteve. • Projektim i përshtatshëm, trainim në masat e sigurisë të operimit dhe mirëmbajtjes.
Mjedisi Akustik	<ul style="list-style-type: none"> • Zhurma nga punimet ndërtimore, kur janë afër shtëpive dhe pallateve). 	<ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktohen afate të punimeve për të minimizuar shqetësimet. • Të përdoren metoda dhe pajisje të

		<p>përshtatshme ndërtimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> Të kufizohet kalimi i trafikut në zonat rezidenciale.
Mjedisi biologjik		
Habitatet Natyrore	<ul style="list-style-type: none"> Shqetësimi i habitateve natyrore nga ndërtimi p.sh. pluhuri, zhurma, punimet jo-sezonale, vendndodhje jo e mirë e kantierit, hedhje e mbeturinave të patrajuara, etj. Ndryshimet në rregjimin e burimeve ujore. 	<ul style="list-style-type: none"> Vendndodhje e kujdesshme e kantierit, kryerje me kujdes e shtrirjes, projektimit të tubacioneve dhe strukturave dhe përcaktimi i kohës së punimeve (sezonale). Përzgjedhja me kujdes e pikave të hedhjes së mbeturinave dhe metodave. Mbrojtja e zonave të ndjeshme brenda/afër kantierit. Respektimi i kërkesave minimum për punimet sezonale.
Fauna dhe Flora	<ul style="list-style-type: none"> Humbja ose degradimi mbas ndërtimeve, sidomos për arsye të punimeve jashtë sezonit, ndryshimet në rregjimet mjedisore, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> Vendndodhje e kujdesshme e kantierit, kryerje me kujdes e shtrirjes, projektimit të tubacioneve për të minimizuar efektet, sidomos për speciet e ndjeshme/të rralla. Përzgjedhja e metodave të përshtatshme ndërtimore. Mbrojtja e zonave të ndjeshme brenda/afër kantierit.
Mjedisi social		
Estetika dhe Terreni	<ul style="list-style-type: none"> Efekte lokale vizuale mbas përfundimit të punimeve dhe disa ndryshime në terrenin e përgjithshëm natyror dhe të krijuar, humbje pemësh, bimësie, etj. Zhurma, pluhur, mbeturina, etj. gjatë dhe mbas fazës ndërtimore. 	<ul style="list-style-type: none"> Vendndodhje e kujdesshme e kantierit dhe kryerje me kujdes e projektimit të punimeve, kontroll i objekteve të papërshtatshme. Zëvendësim i pemëve të dëmtuara, strukturave të kufijve, etj. dhe ri- gjelbërim i zonave të punimeve. Kryerje me kujdes e mbylljes së pikave të punimeve dhe hedhjes së mbeturinave.
Shëndeti i Njerëzve	<ul style="list-style-type: none"> Rreziqe për shëndetin dhe sigurinë gjatë dhe mbas fazës ndërtimore. Efekte mbi shëndetin dhe sëmundje nga mbeturinat e materialeve të rrezikshme të 	<ul style="list-style-type: none"> Të zgjidhen kontraktorë me eksperiencë, të përshihen masa sigurie dhe kërkesat mjedisore në dokumentat e kontratës. Të sigurohet informacion mbi masat

	ndërtimit, ujrat e ndotura, trajtim i papërshtatshëm i ujit.	<p>zbutëse. Krijimi i kapaciteteve të theksojë nevojën për punime me siguri, mbikqyrje të mirë, planifikim dhe parashikim të kujdesshëm të punimeve, përfshirja e komunitetit, rrethimi i zonave të rrezikshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Projektim i sakte dhe trainim i përshtatshëm për masat e sigurisë të operimit dhe mirëmbajtjes, procedurat e sigurisë, testim uji, etj. • Hedhje e kujdesshme e mbeturinave.
Objektet Historike/Kulturore	<ul style="list-style-type: none"> • Shqetësim/dëmtime/degradim i objekteve të njohura dhe të pazbuluara. 	<ul style="list-style-type: none"> • Vendosje/kryerje e kujdesshme e punimeve; masa të posacme për zonat/burimet e njohura. • Të ndalohet puna menjëherë në afërsi të zbulimeve dhe të priten udhëzime nga autoritetet përkatëse në rast se zbulohen objekte të rëndësishme të vecanta.

➤ Masat lehtësuese për dherat

Sasia e dherave të hequra në sipërfaqe gjate punimeve duhet të grumbullohet në vende të caktuara ku nuk ka veprimtari. Dheu përbehet në një masë të madhe nga mbeturina vegjetale të pasura me lende organike dhe do të përdoret me vonë gjate rehabilitimit të sipërfaqeve të zhveshura si dhe në shtresën e sipërme të kanalit të ujësjetillës.

Germimi i shtresave më poshtë duhet të vazhdojë me radhe dhe ato depozitohen në anën tjetër të kanalit për t'u mos u përzier me shtresën sipërfaqësore dhe për tu ripërdorur për mbushjen e kanalit gjate punimeve për rrjetin e rri të shpërndarjes së ujit.

Shtresat e cakëllit dhe rerave me madhësi të ndryshme që do të përdoren sipas projektit teknik nuk duhet të mbeten në sipërfaqen e tokës në asnjë rast.

Materialet e germuara që janë të menduara për rishfrytezim do të menaxhohen dhe trafikohen deri në minimum dhe do të depozitohen në një mënyrë që të minimizohet efekti i motit. Koha ndërmjet germimit dhe rishfrytezimit gjate periudhave të thata do të mbahet në një minimum. Gjate periudhave të zgjatura të thatësirës kontraktori do të ndalojë germimet dhe do të vendosë këto materiale për të parandaluar degradimin për shkak të thatësirës.

Tabela 4: Ndikimet dhe masat lehtësuese për, gjeologjinë dhe dherat gjatë ndertimit

Veprimtaria	Burimet e ndikimit	Impakti	Magnituda	Masat zbutëse
Ri-shfrytezimi i materialeve të dherave	Ndertimi i rrjetit.	Zhurma dhe pluhuri që vjen nga transportimi i materialeve. Humbja e dherave me vlerë për shkak të transportimit dhe depozitimit të pasakte.	E lehtë	Dherat e germuar që duhet të përdoren për rimbushje do të transportohen dhe depozitohen sic specifikohet në dokumenta.
Kontaminimi i dherave	Ndertimi i rrjetit.	Derdhjet aksidentale të karburantit të automjeteve.	E lehtë	Masa të caktuara për kontrollin e ndotjes për tu zbatuar nga kontraktori.

➤ **Ujërat sipërfaqësore dhe nentokesore**

Ujërat Nentokesore

Ekziston mundësia për ndotjen e ujërave nentokesore nga derdhjet e impiantit të ndertimit dhe derdhjet aksidentale të gazrave dhe karburanteve. Do të merren masa të përshtatshme për kontrollin e impianteve të cilat do kryhen nga Kontraktori gjatë ndertimit për të zvogëluar sa më shumë impaktet.

Ujërat Siperfaqësore

Një impakt negativ mund të ndodhë në rrjetet e vogla drenazhuese.

Gjatë ndertimit mund të ndodhin impaktet e mëposhtme të mundshme dhe për secilin prej tyre rekomandohet:

- Rezervat e materialeve të ndertimit, si asfalti, vaji dhe kimikatet nuk duhet të magazinohen afër asnjë sipërfaqeje të vijave ujore, apo puse uji. Rezervat do të vendosen në sipërfaqe të mbyllura, të mbuluara me shtresa (carcarfe) mbyllesë ose me një cati me të qëndrueshme ose e rrethuar nga një portë për të parandaluar rënien dhe humbjen.

- Masat e kontrollit të ndotjes duhet të vendosen në vend gjatë procesit të ndërtimit. Pajisja me skela dhe rregullatore/gardhimet prej balte.
- Gjatë fazës së hedhjes së betonit, mbyllja e kanaleve në mënyrë që të shmangët shperthimi i ujit dhe hedhja e betonit në tokë dhe në ujera nëntokesore, do të merren disa masa si psh. pozicionimi i mbrojtjes së mbulesës për të mbajtur derdhjen.
- Në rastin e një firoje të kimikateve, naftës nga makineritë e ndryshme ose rrjedhjeve gjatë ndërtimit, do të vendoset nga kontraktuesi një program i masave për mbrojtjen e ujerave sipërfaqësore dhe ujerave nëntokesore.

Tabela 5: Permbledhje e ndikimeve dhe masave lehtësuese mbi ujerat sipërfaqësore dhe nëntokesore gjatë ndërtimit

Komponenti i prekur	Burimet e ndikimit	Ndikimi	Rendesia	Masat zbutëse
Cilesia e sipërfaqes ujore	Shkarkimi i të carave në kanalet ujore/rrjedhjet.	Ujja e cilesise se ujit.	E lehte	Ndërtimi i rrethimeve me mur.
Cilesia e sipërfaqes ujore	Ndotje të tjera të lidhura me aktivitetet e ndërtimit do të hyjnë në rreke.	Ujja e cilesise se ujit.	E lehte	Masat e kontrollit të ndotjes që do të vendosen aty gjatë ndërtimit.
Ujerat nëntokesore gjatë ndërtimit	Nxjerrja e materialeve të sipërfaqes do të rrite dobësinë/cenueshmërinë e ujerave nëntokesore.	Rritja e cenueshmërisë së ujerave nëntokesore.	E lehte	Sigurimi i masave të duhura për kontrollin e ndotjeve që do të vendosen aty nga kontraktuesi gjatë ndërtimit.
Ujerat nëntokesore gjatë ndërtimit	Impianti i ndërtimit rrjedh.	Firrot aksidentale të vajerave dhe karburanteve të makinave.	E lehte	Si me sipër

➤ Cilesia e ajrit

Faza e ndërtimit të një projekti si ky është një burim i mundshëm i emetimeve të lendeve të vecanta të vogla që mund të kenë një efekt të perkohshëm mbi cilesinë e ajrit në zonën e projektit.

Gjate fazes se ndertimit emetimi i pluhurit eshte i lidhur me aktivitete te ndryshme si psh. largimi i shtreses se punueshme, germimi i materialit tokesor dhe ndertimi i strukturave. Emetimi i pluhurit varet se pari ne kushtet e motit dhe ne nivelin e aktivitetit dhe te llojit te veprimeve qe po kryhen. Gjithashtu pluhuri ngrihet nga rrotat e automjeteve te renda te ndertimit ndersa ato kalojne pergjate vendit te ndertimit gjate kushteve te motit te keq.

Rezervat e materialeve te humbura mbahen zakonisht ne kushte te hapura per shkak te nevojës per akses te vazhdueshem tek to nga ekskavatoret dhe ngarkuesit etj. Emetimi i pluhurit nga keto materiale rezerve mund te dale si shkak i ketyre aktiviteteve:

- ndikimi i ererave te forta
- ngarkimi i kamioneve per transport ne vendet e punimeve

Ne zonen e projektit ne fjale, zonat qe do te vuajne me shume per shkak te emetimit te mundshem te pluhurit gjate ndertimit jane ato afer rrugeve. Megjithate rekomandohet qe vezhgimi i cilesise se ajrit ne zonat perreth vendeve ku eshte ndermarre ndertimi gjate procesit te ndertimit ne menyre qe te shfaqet sa me heret te jete e mundur cdo problem qe del nga emetimet si pasoje e procesit te ndertimit.

Masat zbutëse përfshijnë mbulimin e vendeve/materialeve që gjenerojne pluhur si dhe zbatimin e masave te shuarjes se pluhurit:

- Lagia e aneve te rrugeve,perdorimi i mjeteve ruajtese per te kufizuar emetime te pluhurit
- Kufizimi i shpejtesise se mjeteve ne rruge
- Ne menyre qe te mbahet/ruhet cilesia e ajrit dhe te shmanget konfliktet me banoret lokale, eshte e keshillueshme qe stabilizimi i tokes/baltes duhet te behet vetem:
 - o gjate periudhave me shpejtesi ere te ulet
 - o ne zonen e ekstradimit/prejardhjes
 - o ne sektoret e vecante ne mes zonave ku nuk ka mbjellje te ndjeshme, ne menyre qe te perfshihet ne menyre te natyrshme pluhuri ajror
- Duhet te jene nen kontroll gjithashtu edhe linjat e transportit te perdorura per shperndarjen e materialeve.
- Minimizimi i kohes se qendrimit në vend-ruajtje apo magazinim të materialeve të ndërtimit.

➤ **Zhurma**

Nje nga ndikimet me te vecanta shkaktuar nga trafiku eshte perhapja e zhurmes tek njerezit qe jetojne ne afersi tezones.

Gjate ketij studimi nuk jane bere matje per zhurmen e mjedisit. Nuk ka matje precise te disponueshme per zonen ne fjale por nuk eshte parashikuar te kete ndonje vend ku niveli i

zhurmes do t'i afrohet atyre qe paraqesin nje bezdi te ndjeshme tek banoret lokale, ose qe do te paraqesin lloje kercenimesh per shendetin.

➤ **Masat lehtesuese**

Dokumentat e kontrates do te specifikojne qartesisht qe kontraktuesi, i cili do te kryej ndertimet e projektit ne fjale do te jete i detyruar te marre masa specifike per pakesimin e zhurmes dhe te perputhet dhe me rekomandimet e komunitetit europian.

Keto masa do te sigurojne qe:

- Asnje impiant i perdour ne vend nuk do te lejohet te shkaktoje nje bezdi publike si pasoje e zhurmes,
- Te gjitha makinat dhe impiantet mekanike do te pershtaten me silenciator efektive dhe te mbajtur ne funksion te mire gjate kohes se kontrates,
- Makineria qe eshte perdorur pa nderprerje do te fiket ose t'i ulet shpejtesia ne minimum (ose t'i mbyllet valvula) gjate periudhes kur nuk perdoret.
- Cdo impiant si psh. gjenerator ose pompe, qe kerkohet te veproje para dhe pas oreve te ligjshmete punes, do te rrethohet nga nje mbyllje akustike ose nga ndonje mbylles portativ.

Tabela 6: Permbledhje e ndikimeve kryesore dhe masat lehtesuese rreth zhurmes

Faza	Burimi i ndikimit	Ndikimi	Rëndësia	Masat zbutëse
------	-------------------	---------	----------	---------------

Ndertimi	Trafiku i ndertimit, impianti, kompresoret, etj. Veprimi i hapjes.	Aktivitetet e vendeve te ndertimit mund te shkaktojne shqetesime lokale si pasoje e zhurmes se tepert.	E lehte deri ne lokalisht e mesme	Dokumentat e kontrates do te specifikojne qartesisht se kontraktuesi i cili ndermerr punimet per zbatimin e projektit te propozuar do te jete i detyruar te marre masa specifike te pakesimit te zhurmes dhe te perputhet me MMPAU si dhe me rekomandimet e Komunitetit European
----------	--	--	-----------------------------------	--

➤ Gjenerim i mbetjeve

Aktiviteti do te shoqerohet me gjenerimin e mbetje te ngurta por keto mbetje nuk do te jene te demshme dhe kryesisht vijne nga:

Mbetje inerte;

Dhera te germuara;

Mbetje plastike;

Mbetje te amballazheve, etj

Subjekti do gjeneroj mbetje inerte, mbetje te materialeve te ndertimit, si dhe mbetje te ngjashme me ato urbane, nga konsumi i ushqimit te punonjesve gjate kohes se pushimit.

Gjate fazes se ndertimit do te menjanohen krijimi i mbetjeve te amballazheve apo te tjera duke inkurajuar furnizimin rifuxho te materialeve te ndertimit.

➤ Socio - ekonomia

Punimet e ndertimit do të interferojne me shërbimet ekzistuese nëntokësore (si p.sh tubacionet e ujit ekzistuese, linjat e komunikimit (internet, telefoni, nese, ka) dhe kabllot elektrike), dhe mund të kete pezullime të përkohshme të shërbimit. Shmangia e shërbimeve te tjera duhet të konsiderohet me kujdes gjate hartimit te projektit te detajuar teknik dhe gjate procesit te ndertimit te vepres.

Ne keto raste kontraktuesi duhet te pergatise nje plan-veprim te detajuar perpara cdo hapi te aktivitetin te tij ne vendngjarje. Kjo duhet te parashikoje akomodimin dhe mbrojtjen e te gjitha sherbimeve komunale publike te vendosura ne vendin e aktivitetit, si kabllot elektrike, tubat e furnizimit me uje apo lehtesime te tjera qe mund te rezultojne nga nje vezhgim ne vendndodhje. Kontraktuesi mund te koordinoje aktivitetet me ndermarrjet pergjegjese te cilat kane pronesine e ketyre rrjeteve si psh: KESH ne menyre qe te pakesohet mundesia e demtimeve dhe koha e rilidhjes me lidhjet e reja me rrjetin ekzistues.

Ky plan do te rishikohet fillimisht nga inxhinieri sipermarres dhe kontraktuesi duhet te filloje implementimin pas aprovimit final te punedhenesit/ndermarresit.

Trafiku, ndotja e ajrit, zhurmat dhe shqetesimet per kembesorët dhe pronarët e aktiviteve tregtare duke u sjelle probleme me biznesin jane problem jo-potenciale per t'u trajtuar persa i perket shtrimin te tubacioneve te ujit, sidomos kur perdoret metoda per germimin e çarjen e terrenit sikurse propozohet ne projekt. Masat zbutese përfshijnë rregullimin e trafikut në kalimet rrugore, ndërtimin e rrugëve të ndërmjetme, duke kerkuar mundesi per zgjedhjen e rrugëve te transportit qe reduktojne trafikun, shmangien e trafikut në orët e pikut te tij, si dhe rikthimin e rrugëve ne gjendjen e meparshme sa më shpejt të jetë e mundur.

➤ **Impaktet Pozitive te Projektit**

Linja e dergimit te furnizimit me uje te aeroportit te Vlores, do të ketë përmirësim domethënës të sistemit të furnizimit me ujë.

Linja e rehabilituar e furnizimit me ujë do të inkurajojë zhvillimin ekonomik të zonës dhe përmes disa rekomandimeve të përgjithshme mund të ndihmojë për t'u shndërruar në një mjet të fuqishëm për zhvillimin e bizneseve lokale, të cilat do të drejtohen drejt sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë nëpërmjet projekteve të ndryshme.

Gjithashtu, do të inkurajojë punësimin e banorëve vendas gjatë fazës së zbatimit të investimit.

11. PLANI I MONITORIMIT

Eshte pergatitur nje Plan Monitorimi si pjese e studimit te VNM-se me qellim qe te percaktohen masat dhe procedurat mjedisore qe duhet te adoptohen per projektin e propozuar dhe per te identifikuar ato pergjegjese per zbatimin e tyre.

PMM-ja percakton ritmin, frekuencen, kohezgjatjendhe koston e masave lehtesuese ne nje program zbatimi dhe i perfshin keto veprime ne planin e projektit.

Plani monitorimit mjedisor cakton menytrat me ane te cilave do te kryhen monitorimi i ndikimeve ne mjedis dhe zbatimi i masave lehtesuese gjate fazes se ndertimit. Monitorimi do te fokusohet ne nje numer te kufizuar impaktesh te identifikuara gjate VNM-se ne menyre qe te siguroje nje efikasitet te masave lehtesuese te planifikuara.



Qellimi i planit të monitorimit të mjedisit është që të sigurojë që gjithë puna e ndermarre për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrjetit të furnizimit me ujë në zonën e Novoseles, të jetë nga ana mjedisore e sigurtë, në konformitet me ligjet shqiptare dhe mundësisht të plotësojë parashikimet e Vlerësimit të Ndikimit mbi Mjedisin.

Parametrat që do të monitorohen: toka, ujrat, ajri.

- Toka do të monitorohet nga projektuesi dhe supervizori gjatë punimeve për rehabilitimin e tubacioneve të dërgimit të stacioneve të pompimit, depove dhe punimeve në rrjetin shpërndarës të ujësjetës në zonat që përfshin projekti.
- Uji do të monitorohet për shpërndarje (sipas planit të monitorimit).
- Ajri do të monitorohet gjatë kohës së ndërtimit (sipas planit të monitorimit).
- Të mos lejohen ndërhyrje të jashtëligjshme në rrjet.
- Do të analizohen dhe monitorohen parametrat e ujit të pijshëm para dhe pas klorimit të tij (sipas planit të monitorimit).

Tabela 7: Plani Monitorimit

Faza	Parametri qe do te monitorohet	Ku do te monitorohet	Si do te Monitorohet	Kur duhet te monitorohet	Pse duhet te monitorohet
<u>Ekzekutimi i Punimeve</u> <u>Materiali Ndertimit</u> - Linjat e dergimit - Matesat e ujit - Tubot etj	Pajtueshmëria me specifikimet teknike / certifikimin / licencën etj	Ne kampin e ndertimit	Inspektim Testim	Perpara punimeve	Te sigurohet përputhshmëria e punës ne favor te mjedisit, shëndetit dhe sigurisë
<u>Transporti i Materialeve</u> - Materialet e renda - Transportimi i dherave etj - Menaxhimi i Trafikut	Kamione te mbuluar Perzgjedhja e oreve te punes	Ne kampin e ndertimit Ne kampin e nderimit	Supervizim Supervizim	Inspektime rastesore gjate punes Inspektime rastesore gjate punes	Te sigurohet përputhshmëria e punës ne favor te mjedisit, shëndetit dhe sigurisë Te sigurohen masat që zvogëlojnë bllokimet e trafikut dhe ndotjen e ajrit dhe zhurmës
<u>Kantieri i ndertimit</u> - Demtimi i dherave - Ndotje akustike per popullsine/banoret dhe	Toka/muret Nivelet e lejuara	Ne kampin e ndertimit Ne kampin e	Supervizim Supervizim	Inspektime gjate punes ne rast shiu Matja me pajisje të duhura gjatë punimeve /	Te sigurohet përputhshmëria e punës ne favor te

Faza	Parametri qe do te monitorohet	Ku do te monitorohet	Si do te Monitorohet	Kur duhet te monitorohet	Pse duhet te monitorohet
kafshet	te zhurmes	ndertimit/Pran e zones se banuar		kur ka ankesa nga banoret	mjedisit, shëndetit dhe sigurisë
- Ndotja e Ajrit	Pluhurat	Ne dhe pranë kampit te ndertimit	Ne perputhje me kerkesat e lejes se mjedisit	Gjatë shpërndarjes se materialeve te ndërtimit	
- Vibrimet nga makinerite e renda per ndertim	Oret e limituara te punes	Ne kampin e ndertimit	Inspektim dhe regjistrim te te dhenave	Inspektim rastesor dhe ne rast ankesash	Te sigurohet përputhshmëria e punës ne favor te mjedisit, shëndetit dhe sigurisë
- Trafiku gjate ndertimit	Plani i menaxhimit per trafikun/ Tendence e trafikut	Ne dhe pranë kampit te ndertimit	Inspektim dhe mbikqyrje	Gjate punimeve/ nje dite ne jave gjate periudhave te pikut	
- Limitimi i hyrjes dhe perdorimit te shpejtesise ne zonen ku do te zbatohen punimet	Hyrjet e aksesueshme alternative	Ne kampin e ndertimit	Supervizim	Gjate punimeve	

Faza	Parametri qe do te monitorohet	Ku do te monitorohet	Si do te Monitorohet	Kur duhet te monitorohet	Pse duhet te monitorohet
- Sigurimi i pajisjeve ne momentet qe punimet nderpriten	Shikueshmeria dhe pershtatshmeria	Ne kamp dhe afer tij	Inspektim	Nje here ne jave	
- Ndotja e ujit gjate pjeses se zevendesimit te linjave te ujit dhe nga rrjedhet aksidentale te mundshme te vajrave te makinerive	Cilesia e ujit	Ne kampin e ndertimit dhe tek familjaret	Laborator portable dhe analiza te ujit nga Drejtoria Rajonale e Shendetit	Dy-tre here ne jave, ne varesi te ankesave te residenteve	Te sigurohet përputhshmëria e punës ne favor te mjedisit, shëndetit dhe sigurisë
- Demtimi i tokes agrikulturore	Sigurimi / zgjidhja e çështjeve të tokës	Ne kampin e ndertimit	Supervizim	Gjate punimeve	Te sigurohet përputhshmëria e punës ne favor te mjedisit, shëndetit dhe sigurisë
- Sigurimi i punetoreve	Pajisjet mbrojtëse (veshjet, çizmet, helmetat, syzet etj)	Ne kampin e ndertimit	Inspektim	Gjate punimeve	Te sigurohet përputhshmëria e punës ne favor te mjedisit, shëndetit dhe sigurisë

12. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmtim të mjedisit ndërkufitar. Projekti nuk ndikon në çënimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit as të shteteve fqinje, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore ndërkufitare, nuk ndikohet cilësia e ajrit në kontekstin ndërkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendndodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtetet fqinje.

13. CERTIFIKATËN DHE LICENCËN PËRKATËSE TË QKL-SË, TË SPECIALISTIT QË KA HARTUAR RAPORTIN PARAPRAK TË VNM-SË.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 2256 113 Fax. 04 2270 627 - www.moe.gov.al

Nr. 5013 Prot.

Tiranë, më 04.02 2013

Nr. identifikues 98

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr.1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Znj. DITIKA QATIPI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Fatmir MEDIU





LICENCË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes



Emërtimi përshkruas i veprimtarisë
Veprimtarië e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis, (auditim mjedisor dhe vlerësim i ndikimit në mjedis)

Kufizime specifike
Licenca ushtrohet sipas kujtimeve në legjislativin në fuqi

Detyrime specifike
Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislativin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë
Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

LN: 1574-03-2014 RUIS/NIPT: K61617040L

Subjekti: "TAULIANT" SHPK
Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, Rruga Ferid Xhajlic, Pallati 60/4,
Shkalla 1, Ap. 3

Kodi: III.2.A (1+2) Kod tjetër:
Data e ishimit: 04/03/2014 Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nivëlkategoria
Veprimtarië e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike
1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Në emër të ministrit

[Signature]

SHQIPËRIE
Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes

